



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI**

Komisioni i Ligjeve

RELACION

Per Dekretin nr.3053, date 7.06.2001 "Per kthimin e ligjit nr.8805, date 17.05.2001 "Per dhenien e lejes minerare shoqerise "Elbasan Cement Factory"Sh.A ne Elbasan".

Komisioni i Ligjeve ne daten 3 tetor 2001 mori ne shqyrtim Dekretin nr.3053, date 7.06.2001 "Per kthimin e ligjit nr.8805, date 17.05.2001"Per dhenien e lejes minerare shoqerise "Elbasan Cement Factory"Sh.A ne Elbasan", paraqitur nga Presidenti i Republikes.

Kuvendi i Shqiperise me ligjin nr.8805, date 17.5.2001 ka vendosur qe Shoqeria "Elbasan Cement Factory" SLLA Elbasan t'i jepet leja minerare e shfrytezimit te karrieres se gurit per minerarin gelqeror ne zonen e Letanit dhe te minerarit argjil ne zonen e Bradasheshit per nje afat 100 vjeçar sipas kushteve te percaktuara ne ligjin nr.7796, date 17.12.1994 "Ligji minerar i Shqiperise".

Presidenti i Republikes me dekret nr.3053, date 7.06.2001 e ka kthyer per rishqyrtim edhe njehere ne Kuvend ligjin bazuar ne nenet 85 dhe 93 te Kushtetutes.

Arsyet dhe motivimi i kthimit te ketij ligji per rishqyrtim nga Kuvendi i bere nga Presidenti i Republikes jane si me poshte:

- 1- Kuvendi te kete parasysh qe ligji nr.8805, date 17.05.2001 te harmonizohet me ligjet e tjera qe rregullojne te njejtat marredhenie juridike, pasi ne ligjin baze per minierat ne nenin 69 te tij jane parashikuar procedurat, si dhe afatet maksimale te dhenies se lejeve ne te cilen eshte parashikuar si afat maksimal i shfrytezimit te

karrierave jo me shume se 10 vjet me te drejte ripertesitje çdo vit sipas procedurave qe parashikon ky ligj.

- 2- Ligji nr.8805, date 17.05.2001 i miratuar nga Kuvendi kaperecen kufijte e zbatimit qe parashikojne keto dispozita te miratuara po nga vete ai. Nderkohe qe ai, pra Kuvendi, duhet te kishte krijuar hapesiren perkatese ne ligjin baze ne fuqi dhe jo te jepte zgjidhje te tjera duke vepruar ndryshe nga dispozitat e ligjit organik "Per lejet minerare".
- 3- Eshte detyre e Kuvendit qe perputh dhe pajton sa me drejte ligjet qe ka miratuar dhe nese Kuvendi dhe Keshilli i Ministrave do te gjykojne se ne raste te vecanta afati maksimal i dhenies se lejeve duhet te jete mbi 10 vjet, nje vullnet i tille i diktuar nga nevojat e kushtet per te thithur investimet ne fushen e shfrytezimit te pasurive minerare, duhet te gjeje pasqyrim ne radhe te pare ne ligjin baze qe rregullon keto marredhenie duke bere amendimin e nenit 69 te ligjit minerar te vitit 1994 me qellim krijimin e hapesirave ligjore per te realizuar nje vullnet te tille.
- 4- Eksistenca e dy ligjeve qe rregullojne te njejtat marredhenie, siç eshte rasti ne dhenien e lejeve minerare ne menyra te ndryshme sjell perplasje, anomali, konfuzion dhe orientime te ndryshme ne zbatimin konkret te tyre

Komisioni i Ligjeve, pasi shqyrtoi kerkesen e Presidentit me motivimet perkatese per kthimin e ligjit nr.8805, date 17.05.2001 dhe pasi degjoi perfaqesuesit e Ministrise Ekonomike dhe Privatizimit, te cilet kerkuan qe Kuvendi te miratoje ligjin e mesiperem, **çmon se problemi ne fjale eshte thjesht ligjor dhe eshte detyre e ketij Komisioni te shprehet per mosperputhjet ligjore, te pretenduara ne dekretin e Presidentit.**

1. Pare ne kete kontekst, Komisioni vleresoi se marredheniet juridike qe rregullojne marredheniet baze ndermjet shtetit dhe personave fizike apo juridike, qe perfitojne te drejtat minerare, jane te percaktuara ne ligjin nr.7795, date 16.2.1994. Ne kete ligj, njekohesisht, jane te percaktuara edhe kushtet lehtesuese e specifike per te nxitur investimet private, neni 100 i ketij ligji.

2. Ne kushtet kur Shoqeria Anonime Elbasan Cement Factory ka kerkuar nenshkrimin e nje marreveshjeje lehtesuese me zoteruesin e lejes qe ne rastin e nenit 44 te ketij ligji eshte i autorizuar Ministri, po ne nenin 100 te ketij ligji jane te percaktuara kushtet lehtesuese dhe perfitimet specifike qe nxisin investimet private. Ne keto kushte lehtesuese sipas

5

percaktimeve te nenit 100 nuk parashikohet si kusht lehtesues shtyrja e afatit te lejes me shume se 10 vjet, ndonese Ministria e Ekonomise Publike dhe e Privatizimit ka hyre ne negociata me shoqerine investitore per dhenien e kushteve lehtesuese tej marzheve te parashikuara nga ligji ne kuptim te nenit 44 te ligjit minerar. Keto tratativa behen vetem ne rastet kur ka nje marreveshje me zoteruesin e lejes minerare. Ne rastin konkret investitori, para shqyrtimit te ketij ligji, nuk ka pasur leje minerare. Vetem pas marrjes se kesaj leje Ministria eshte e detyruar te negocioje dhe te hyje ne tratativa lehtesuese brenda kuadrit ligjor (nenit 100 te ligjit per minierat). **Dhenia e lejes minerare me ligj te posaçem per shoqerine Elbasan Cement Factory si kusht lehtesues per nje periudhe 100 vjeçare ben te mundur jo vetem qe ky ligj te shmanget nga ligji baze, nderkohe qe ai ne dispozitivin e tij i referohet atij, por sjell perplasje dhe çorientime në ligjin organik "Per minierat".**



3. Duke çmuar se Kuvendi ka per detyre jo vetem te shmange perplasjet e ligjeve qe miraton, por t'i harmonizojë ato, Komisioni vlereson se në rastin konkret ne ndodhemi perpara situates se perplasjeve të dy ligjeve qe rregullojne te njejten marredhenie. Gjithashtu, Komisioni çmon se evitimi i perplasjes së dy ligjeve, harmonizimi i legjislacionit, si dhe realizimi i qellimit per te mbeshtetur Qeverine me qellim qe t'u hapet rruga dhe t'u jepen lehtesira investitoreve te huaj mund te behet duke u propozuar nga ana e Keshillit te Ministrave Kuvendit amendimi dhe shtesat ne nenet 69 dhe 100 te "Ligjit minerar", ku te percaktohen në to si klauzole e veçante ne marreveshjet lehtesuese dhe perfitimet specifike te zoteruesve te lejes dhe organit perkates shteteror, edhe e drejta per shfryzimin e karrierave minerale tej afatit 10 vjeçar.

4. Sa me siper Komisioni me shumice votash, bazuar edhe ne argumentet ligjore te mesiper, pranoi kerkesen e Presidentit per kthimin e ligjit nr.8805, date 17.05.2001 "Per dhenien e lejes minerare Elbasan Cement Factory", Sh.A Elbasan", Keshillit te Ministrave.

5. Njekohesisht ne Komision u shfaq edhe nje mendim i pakices, i cili arsyetoi se nuk duhet pranuar Dekreti i Presidentit, pasi ligji nuk bie ne kundërshtim me Kushtetuten dhe praktiken e ndjekur nga ky Kuvend per rastet analoge.

Spartak BRAHO

KRYETAR



15.10.2001



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Ekonomisë , Financave dhe Privatizimit

RELACION

**PËR DEKRETIN NR.3053, DATË 7.6.2001 "PËR KTHIMIN E LIGJIT
NR.8805, DATË 17.5.2001 "PËR DHËNIEN E LEJES MINERARE
SHOQËRISË "ELBASAN CEMENT FACTORY" SH.A. NË ELBASAN**

Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit në disa mbledhje të tij ka shqyrtuar Dekretin nr.3053, datë 7.6.2001 "Për kthimin e ligjit nr.8805, datë 17.5.2001 "Për dhënien e lejes minerare Shoqërisë "Elbasan Cement Factory" SH.A. në Elbasan.

Gjatë diskutimit të këtij dekreti Komisioni, pasi dëgjoji argumentet e zotit Mustafa Muçi, Ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, e përqendroi diskutimin rreth përputhjes së ligjit nr.7796, datë 7.12.1994 "Minerar i Shqipërisë" me ligjin nr.8805, datë 17.5.2001 "Për dhënien e lejes minerare Shoqërisë "Elbasan Cement Factory" SH.A. në Elbasan.

Komisioni është i mendimit se nuk ka kontradiktë me nenin 69 të ligjit minerar, pasi kompetenca e dhënies së një leje minerare me afat 10-vjeçar është e Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Dhënia e një leje me afat më të gjatë se 10 vjet mund të realizohet vetëm me ligj të veçantë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Duke patur parasysh rëndësinë dhe leverdinë ekonomike të investimit që do të kryhet, Komisioni gjykoji se periudha afatgjatë e lejes minerare është e nevojshme për të garantuar efektivitetin e investimit që do të bëhet.

**KRYETARI I KOMISIONIT
Ylli BUFI**

Tiranë, në 2.10.2001



REPUBLICA E SHQIPERISE
KUVENDI
KOMISIONI PER INDUSTRIRE, TRANSPORTIN, PUNET
PUBLIKE DHE TREGTISE

RELACION

Per: "Dekretin per kthimin e ligjit nr. 8805, date 17.5.2001 "Per dhenien e lejes minerare shoqerise "Elbasan Cement Factory" S.H.A. ne Elbasan"

Komisioni per Industrine, Transportin, Punet Publike dhe Tregtine ne mbledhjen e tij te dates 3.10.2001, shqyrtoi dekretin e Presidentit per kthimin e ligjit nr. 8805, date 17.5.2001 "Per dhenien lejes minerare shoqerise "Elbasan Cement Factory" S.H.A. ne Elbasan.

Komisioni pasi shqyrtoi dekretin ne fjale duke rishikuar edhe ligjin Minerar Shqiptar arsyetoi si me poshte:


- Dhenia e lejes Minerare me nje afat 100-vjecar eshte bere duke marre ne konsiderate kerkesen e shoqerise "Elbasan Cement Factory" e cila kerkon garanci afatgjate per lejen minerare, pasi investimi qe do te kryeje ne Elbasan eshte rreth 60 milion \$.
- Ligji Minerar Shqiptar per keto lloje lejesh ka afatin maksimal deri ne 10 vjet dhe investitori kerkon garanci per nje kohe me te gjate.
- Dhenia e kesaj leje minerare me ligj nga Parlamenti per mendimin tone nuk bie ndesh me ligjin Minerar Shqiptar.

Per sa me siper Komisioni shprehet per mbetjen ne fuqi te ligjit nr.8805 date 17.5.2001.

Tirane, me 3.10.2001

Kryetari

Ilir ZELA


15.10.2001